

### Ilustrimi i kriterëve të gjelbra të përzgjedhura për sektorin e ndërtimit:

- ✓ Kërkoni paketime të ripërdorshëm për transportin e dërgesave, ose në kontratat me gjenerim të lartë të paketimeve si në sektorët e ndërtimit dhe punimeve kërkoju kontraktorëve të vendosin një nivel minimal dhe të synuar për përdorimin e materialeve me paketime transporti të ripërdorshme.
- ✓ Përfshini një pikë në kontratë që detyron ndarjen në burim, të mbetjeve të krijuara.
- ✓ Përfshini një pikë detyruese në kontratë që në ndërtim, nëse është e mundur, të përdoren materiale që nuk janë të paketuara me paketime plastike (të lirshme/loose, paleta, etj.).

### Ilustrimi i kriterëve të gjelbra të përzgjedhura në aktivitetet publike:

- ✓ Shmangni përdorimin e ambalazheve të depozitushme për ushqimet dhe pijet.
- ✓ Kërkoni gota të ripërdorshme (qelq, porcelan).
- ✓ Përdorni sete (thika, lugë, pirunë) të ripërdorshme.
- ✓ Kërkoni paketime të kompostueshme për ushqimet dhe pijet.
- ✓ Sigurohuni që të kryhet pas aktivitetit procesi i riciklimit / kompostimit / përfuturit të energjisë së mbetjeve.



## Prokurimi Publik i Gjelbër

Kjo fletëpalosje u përgatit në kuadër të projektit “Zbatimi pilot i kriterëve specifikë të prokurimit publik të fokusuar në parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve plastike në Shqipëri” si pjesë e Programit për Grantet e Vogla (SGP/PGV) mbi Mbetjet Plastike, ku komponenti parësor i projektit lidhet me “Veprime të mëtejshme për të adresuar mbetjet plastike sipas Konventës së Bazelit” (BRS-Norad-2), financuar nga Agjencia Norvegjeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Norad).

Prokurimi i gjelbër publik (PGJ) përbën një instrument vullnetar të politikës mjedisore i cili mund të mbështesë qasjen miqësore ndaj mjedisit në momentin e zhvillimit të aktiviteteve rutinë, të tilla si: ofrimi i pije freskuese në kuadër të aktiviteteve të autoriteteve publike, organizimet e hapura, ngjarjet sociale, trajnimet, etj. Kjo mund të ndikojë prodhimin dhe menaxhimin e mbetjeve në mënyrë miqësore me mjedisin dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, zhvillimin e infrastrukturës së mbetjeve në vend.



BASEL CONVENTION

Shteti dhe bashkitë janë blerësit më të rëndësishëm të mallrave dhe shërbimeve në vend dhe, vëllimi i burimeve financiare të tyre është pakrahasueshmërisht më i lartë se në sektorin privat. PPGJ mund të ketë një efekt pozitiv në strukturën e ofertës, mund të çojë në ndërtimin e objekteve të reja dhe të mbulojnë nevojat e shtetit dhe qeverisjes vendore. Nëse kriteret e gjelbra zbatohen do të ketë një ndikim pozitiv domethënës në mjedisi, por diçka e tillë nuk nënkupton rritje të çmimit të mallrave ose shërbimeve të blera.

*Sipas Ligjit Shqiptar Nr.162, datë 23.12.2020 mbi Prokurimin Publik subjektet e përfshira janë:*

- a) institucionet kushtetuese, institucione të tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale;
- b) çdo entitet:
  - i. i themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm me natyrë joekonomike ose tregtare;
  - ii. që ka personalitet juridik;
  - iii. që financohet kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore ose subjektet e tjera publike, ose të administruara prej tyre ose nga një bord administrativ, menaxherial, mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale apo edhe nga subjekte të tjera publike;
- c) organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete, ose nga një ose disa prej këtyre organeve publike.

## PPGJ si pagesë për parandalimin e mbetjeve plastike



Kur përballemi me problemin e mbetjeve plastike si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, është thelbësore të zgjedhim burimet më të rëndësishme të mbetjeve plastike dhe mundësitë për menaxhimin e këtyre mbetjeve sa më tepër miqësore me mjedisin. Mbetjet plastike prodhohen në të gjithë sektorët dhe në çdo aktivitet si: ushqim dhe katering, tekstile, ndërtim, paketim por edhe në shumë sfera të tjera. Bazuar tek gjendja aktuale e infrastrukturës së mbetjeve në Shqipëri është e rëndësishme të fokusohemi në parandalimin e mbetjeve plastike dhe ripërdorimin e tyre. Disa nga fushat ku është e mundur të reduktohet sasia e mbetjeve plastike të krijuara në aktivitetet e autoriteteve kontraktuese janë:

- a) shërbimet ushqimore, katering
- b) shërbimet e shitjes
- c) parandalimi i paketimit
- d) aktivitetet e zyrës
- e) ndërtimi
- f) veprimtaritë publike, etj

## Ilustrimi i kriterëve të gjelbra të përzgjedhura për sektorin e ushqimit dhe kateringut:

- ✓ Shmangni sendet njëpërdorimshe (enë kuzhine, letrat mbrojtës për tabaka etj.).
- ✓ Përdorni ujë rubineti (me ose pa sistem filtrimi) në vend të ujit në shishe.
- ✓ Vendosni përbërësit e gatimit (erëzat, sheqerin, kripën piperin, salcën etj.) dhe racionet ushqimore në kuti - ku parandalimi i mbetjeve ushqimore, ushqimi i pastër, siguria e konsumatorit dhe marrja në konsideratë e shëndetit publik - lejojnë përdorimin e tyre.
- ✓ Mbani enë kuzhine (pjata, pirunë, lugë, thika etj) dhe mbulesa tavoline të ripërdorshme.
- ✓ Blini produkte të stinës që të jenë të freskëta dhe të kenë paketim minimal.
- ✓ Hiqni shisheet e ujit nga makinat shitëse dhe përdorni ujë rubineti (me ose pa sistem filtrimi) që vjen nga burime të lidhura me ujësjellësin dhe që lejojnë rimbushjen e shisheve.
- ✓ Përdorni kafe me kokërr të plotë (jo kapsula).
- ✓ Vendosni që makinat që shesin pijet e nxehta të mos përdorin gota njëpërdorimëshe ose të mundësohet zgjedhja e përdorimit ose jo të gotave (duke mos qenë opsioni i paracaktuar, kurdo që është e mundur) dhe të ketë kosto ekstra për gotën.